



A hmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 128, datë 3.3.2021

P Ë R

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT
PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT
TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, NË ZONAT E REJA
TË SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pas pikës 3, të vendimit nr.307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

"3.1 Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2021, do të jetë në masën 1 831 932 076 (një miliard e tetëqind e tridhjetë e një milionë e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, pa TVSH, nga të cilat:

- a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 897 566 799 (tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh, pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e

reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.

- b) Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi prej 934 365 277 (nëntëqind e tridhjetë e katër milionë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh, pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACI

**MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 1178/1
DATE 5.3. 2021

MINISTRIT TË SHETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCEVE DHE EKONOMISË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

